



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman

VENDIM

PROJEKT

Nr 9 Datë 20/06/2007

“Për miratimin e lejes së rinovuar, për shfrytëzim inertesh në shtratin e lumit OSUM, subjektit “SHPETIMI” sh.p.k , Berat.

Në mbështetje të nenit 8 të ligjit nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, të vendimit nr. 3, datë 09.01.2003 të Këshillit Kombëtar të Ujit “Mbi procedurat e dhënies dhe rinovimit të lejeve për shfrytëzimin e zhavorreve dhe rërave nga shtretërit e lumenjve”, vendimit nr. 5 date 03.03.2005 te Këshillit Kombëtar të Ujit, Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman .

VENDOSI:

1. Miratimin e lejes së rinovuar për shfrytëzim inertesh në shtratin e lumit OSUM, subjektit juridik “SHPETIMI” sh.p.k.

2. Sipërfaqja e shfrytëzimit: 0,12 km².

3. Kordinatat e shfrytëzimit të zonës bashkangjitur këtij vendimi

Pika 1	X1	4412910	Y1	4506860
Pika 2	X2	4413110	Y2	4506820
Pika 3	X3	4413600	Y3	4506580
Pika 4	X4	4413610	Y4	4506420
Pika 5	X5	4413280	Y5	4506520
Pika 6	X6	4412880	Y6	4506820

4. Ngarkohet AUB Seman për zbatimin e këtij vendimi.

KRYETARI I KBU

Seman

Shahin Bejdaj

PËRGJEGJËSI I AUB

Seman

Ajen GRABOVA

